



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 11 dhe 12.2 shkronja d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenit 9 paragrafi 1.7 të Udhëzimit Administrativ nr.27/2012 MPB - 03/2012 MAPL për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi, si dhe neneve 14 dhe 15 paragrafi 2.4 të Statutit të Komunës nr.01-020/01-0050862/19, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në propozim të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, në mbledhjen e mbajtur më 13 mars 2025, mori këtë,

V E N D I M **PËR MIRATIMIN E PLANIT TË PUNËS TË KËSHILLIT KOMUNAL PËR SIGURI NË** **BASHKËSI PËR VITIN 2025**

Neni 1

Me këtë Vendim miratohet Plani i Punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi në Komunën e Podujevës, për vitin 2025.

Neni 2

Plani i Punës sipas nenit 1 është pjesë përbërëse e këtij Vendimi.

Neni 3

Ky vendimi hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës, përkatësisht konform nenit 81 të ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, nenit 9 paragrafi 8 të Rregullores (QRK) nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, me plotësim ndryshimet e bëra me Rregulloren 06/2021 si dhe Ligjit nr.08/L-284 për shqyrtimin administrativ të akteve të Komunave.

Nr.Prot. 01-016/01-0015041/25
Podujevë, datë, 13 mars 2025



Kryesuesi i Kuvendit
Hilmi Hoxha



KËSHILLI KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI – KKSBB

PLANI I PUNËS

Kalendari i Aktiviteteve të Rregullta për vitin 2025

AKTIVITETI	RAPORTUESI I AKTIVITETIT	BARTESI I AKTIVITETIT	PERIUDHA
¹ Informatë nga Policia për gjendjen e sigurisë në komunë;	Komandanti i Stacionit të Policisë;	Anëtarët e KKSBB;	Në çdo takim
² Informatë nga KFOR-i për sigurinë në komunë;	Përfaqësuesi i KFOR-it;	Anëtarët e KKSBB;	Sipas nevojës
³ Informatë nga FSK-së për sigurinë në komunë;	Përfaqësuesi i FSK-së;	Anëtarët e KKSBB;	Sipas nevojës
⁴ Miratimi i Planit vjetor të punës për 2025 në KKSBB;	Komisioni hartues;	Anëtarët e KKSBB;	Mars
⁵ Miratimi i Planit vjetor të punës për 2025 në Kuvendin Komunal;	Kryesuesi i KKSBB;	Anëtarët e KKSBB;	Prill
⁶ Miratimi i Informatës për punët dhe aktivitetet për 2024 në KKSBB;	Komisioni hartues;	Anëtarët e KKSBB;	Mars
⁷ Informatë e zbatimit të Planit vjetor të punës për 2024 në KKSBB;	Kryesuesi i KKSBB;	Anëtarët e KKSBB;	Prill
⁸ Informatë për planin e Reagimit Emergjent;	Kryesuesi i KKSBB Drejtori i DSHPMSh; Komandanti i Policisë; Shefi i DSHPMSh; Drejtorja e DSHMS;	Anëtarët e KKSBB;	Korrik
⁹ Informatë për Kuvendin e Komunës, për Punën e KKSBB-së në gjashtëmujorin e parë të vitit.	Kryesuesi i KKSBB;	Anëtarët e KKSBB;	Korrik
¹⁰ Informatë për sigurinë në shkollë;	DKA; Komandanti i Policisë;	DKA; Policia e Kosovës;	Shtator - Tetor
¹¹ Informatë për shëndetësin;	Drejtorja e Shëndetësisë	Drejtorja e Shëndetësisë; Shtabi i Emergjencës;	Shtator
¹² Informatë rreth zbatimit të Planit operativ lokal sipas Strategjisë për parandalimin ekstremizmit të dhunshëm që shpie në terrorizëm;	Drejtori i DKA-së; Komandanti i Policisë; Kryetari KBI;	DKA; Policia KBI; DSH MS;	Tetor
¹³ Tryezë Pune me akterët;	Drejtori i DKA; Komandanti i Policisë; Kryetari KBI; Përfaqësues nga Drejtoria kundër terrorizmit, OSHC;	KKSBB/OSHC;	Tetor
¹⁴ Masat parandaluese dhe sensibilizimi i qytetarëve për pasojat nga zjarri gjatë periudhës së korre-shirjeve dhe djegieve të pyjeve, dhe vërshimeve (koordinimi i aktiviteteve në mes DBPZHR, DSHPMSh, SZSH, Policisë, Agjencionin Pyjor, Agjencionin e Menaxhimit Emergjent;	Drejtori i DBPZHR; Komandanti i Policisë; Drejtori i DSHPMSh;	DSHPMSH, DI, APK, AME;	Shtator - Tetor

15	Informatë nga SHZSH për intervenimet dhe gatishmërinë në rastet kundër zjarreve dhe intervenimet tjera;	Drejtori i DSHPMSh; Shefi i SHZSH;	DSHPMSh; SHZSH;	Korrik-Gusht
16	Informatë dhe diskutim për projektet (të infrastrukturës dhe të shërbimeve) që ndikojnë në sigurinë e qytetarëve, që mund të propozohen drejtorive për miratim në Kuvendin Komunal, gjatë periudhës së miratimit të buxhetit të Komunës	Anëtarët e KKSb;	Anëtarët e KKSb; Drejtoritë;	Korrik-Gusht
17	Informatë për gjendjen e pyjeve;	Drejtori i DBPZHR;	DBPZHR; Policia e Kosovës; APK	Shtator
18	Informatë për dukuritë negative dhe masat sensibilizuese kundër këtyre dukurive; Përdorimi i narkotikëve, vjedhjet, dhuna në familje etj.);	Komandanti i Policisë; Drejtori i DSHMSh-së; Drejtori i DKA;	Komandanti i Policisë; Drejtori i DSHMSh-së; Drejtori i DKA;	Shtator - Tetor
19	Informatë për ambientin (realizimi i këtij aktiviteti të bëhet në natyrë);	Drejtori i DPUMM-së dhe Drejtori i DSHMSh- së;	Drejtori i DPUMM-së; Drejtori i DSHMSh-së	Korrik shtator
20	Informatë për sigurinë në komunikacion dhe trajtimi i qenëve endacak;	Policia, DI, DSHPMSh;	Policia, DI, DSHPMSh;	Korrik - Tetor
21	Informatë për rastet e ngritjes së shkallës së gatishmërisë në situatat emergjente, nëse paraqiten gjatë vitit;	Kryetari i Komunës, Komandanti i Policisë, Drejtori i DSHPMSh;	Policia e Kosovës, Shërbimi Zjarrfikës DSHPMSh	Sipas nevojës
22	Gatishmëria për reagim në raste Emergjente Testimi me akterët (simulimi i reagimit dhe koordinimi i akterëve;	Kryetari i Komunës; Drejtori i DSHPMSh;	Akterët e përfshirë në reagimin emergjent	Nëntor
23	Informatë për rastet e kthimit dhe integritetit të qytetarëve në shtëpitë (pronat) e tyre;	Zyrtari për integritet; Zyrtari për kthim dhe komunitete;	ZI, ZKK	Dhjetor
24	Takime të jashtëzakonshme (në rastet e paraqitjes së rasteve emergjente dhe raportime nga shërbimet përkatëse), përveç 6 takimeve tjera obligative;	Kryetari i Komunës Drejtoritë përkatëse; Komandanti i Policisë;	Anëtarët e KKSb	Sipas nevojës
25	Diskutim rreth përdorimit të mjeteve piroteknike;	Inspeksioni, Policia, FSK;	Inspeksioni, Policia	Dhjetor
26	Përveç temave të parapara me Plan, Kryetari i Komunës dhe anëtarët e KKSb mund të propozojnë edhe tema të tjera të veçanta në sferën e sigurisë publike në komunë;	Anëtarët e KKSb;	Anëtarët e KKSb	Sipas nevojës
27	Formimi i Grupit punues për përgatitjen e Planit të Punës 2026; Formimi i Grupit punues për përgatitjen e Informatës për punën e KKSb për 2025.	Kryesuesi i KKSb;	Anëtarët e Grupeve	Dhjetor
28	Informatë për Kuvendin e Komunës, për Punën e KKSb-së në gjashtëmujorin e dytë të vitit.	Kryesuesi i KKSb;	Anëtarët e KKSb;	Dhjetor

Podujevë,

Date 13.03.2025

Nr. Prot. 01-016/01-0015041/25



Kryesuesi i Kuvendit
Hilmi Hoxha

[Signature]